ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ
ΑΡΧΕΙΟ ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΛΑ
Αρ. Εγγρ.: 11 (33-34)



Tiranë, 10 Janar 1938

Zot i nderushem Imzot Kurilaj,

Ju falem nderit, një parë për urimet e bekimet që na dërguat për Vitin e ri; goftë i mbarë edhe për Juve e për tërë Shqipërinë t'onë.

Ju përgjigjem me pak dit vonesë, nga shkaku se s'kam patur ngé, por, nga ana tjetër, se desha të jepnja përgjigje jo të thatë. Tashi kam një herë t'ju bëj të njohur se dha Zoti e mora ~~at~~ Numurat e "Fletores Zyrtare", ato që qé e mundur të gjenin, siç më thanë; i kam gati dhe do t'ua dërgonj me rastin më të parë.

Shpalljen e dhashë në të dya fletoret, që të botohet nga 3 herë dhe do t'ju dërgojnë faturën. Për të parën ish bërë gabim në Shtypshkronjën dhe ish botuar vetëm një herë, po u-dha urdhër që të plotësohet tri herë. Unë u-largova përsëri nga gazeta "Shtypi" që në krye të këtij Viti; ësht e pamundur të punohet me atë njeri dhe sa për age që kish mbetur shpërblimi unë i nxjer dhe veçan; po përpiqem për revistën t'ime "Vatra e Rinis", të cilën po e vashdonj tani e tutje. Kalendari dritaron nesër; u-vonua mjaft për fat të keq, po del i mirë. Artikullin t'uaj e mora nga "Drita", u-mundua mjaft z. Xoxa që t'a gjejë — dhe ju dërgon përshëndetje — dhe ia dorëzova Bedulit për "Predikimin", passi e ndreqa pak.

Z. Naçi ia dhashë të falat dhe bisc-

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΑΚΗ ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ

duam sot për punët që na interesojnë; ka edhe
mejtimet e tij të veçanta — me ~~fryme~~ anti-
logjiàs — për çeshtjen e Seminarit sidomos.
dhe, siç më tha, do t'ju shkruajë veçanë
rishtë këto dit. Siç kuptova unë, ay nuk do
dhe s'mund të shpërngulet që këtej për
t'ardhur në Korçë dhe hédhra profeso-
nale do të jetë për të, më duket, vetëm
"honoris causa". Çeshtja e ndërtesave, siç duket,
s'mund të zgjidhet në një kohë të shkurtër; prandaj
bëtë mirë që zutë me qira dhe vashdoni atje. Për
nxënësit kandidatë këtu gjagen mejtime që s'duhet
të vini shumë kufizime e detyrime.

Me shëndet jemi mirë të gjithë të familjes dhe
Ju puthim dorën e Shenjtërisë Atnore. Dhiakos
(të falasidhe Gagit.

Me nderime e përshëndetje
Nipi i juaj
Vasi Ci

Ju puth dorën me nderime dhe urime për vitin
e ri

Viktoria

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ
ΑΡΧΕΙΟ ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΛΑ
Αρ. Εγγρ.: 11 (34)

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΑΚΗ ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ